		ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS KOSOVO DOCTORS CHAMBER LEKARSKA KOMORA KOSOVA	
Njsela:		Nr. Prot.:	
Unit:	<u>KO</u>	Prot. No.:	<u>15/2023</u>
Jednica:		Br. Prot.:	
Nr. i faqeve:		Data:	<u>26.12.2023</u>
No. of pages:	<u>-17-</u>	Datum:	
Br. stranica:		Prishtinë/s	



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

RREGULLORE

PËR

MARKETING NË OMK

Prishtinë,
Dhjetor 2023

KUVENDI I ODËS SË MJEKËVE TË KOSOVËS në mbështetje të Nenit 19, paragrafit 1, nënparagrafit 1.1 të Ligjit nr. 04/L-150, për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Nenit 22 paragrafi 1 me nënparagrafin 1.1 të Statutit të OMK-së, si dhe Nenit 23 të Rregullores për Procedurat Vendimmarrëse të Organeve të OMK-së, e miratuar në mbledhjen e rregullt të datës 26 dhjetor 2023, miraton këtë:

RREGULLORE
PËR
MARKETING NË OMK

(Teksti i spastruar me plotësime dhe ndryshime të miratuara sipas Vendimit nr. 11/2023 të Kuvendit të OMK-së, datë 26 dhjetor 2023)

Kreu I -DISPOZITAT THEMELORE

Qëllimi

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohen kushtet e shitjes së hapësirës për reklama në ueb-faqen zyrtare të OMK-së dhe Revistën Shkencore të OMK-së.

Neni 2

Kjo Rregullore përveç kushteve të përgjithshme të afarizmit e përkufizon edhe terminologjinë, si dhe i përcakton procedurat dhe mënyrën e porositjes së shërbimit dhe rregullat e publikimit të reklamave në ueb-faqen zyrtare të OMK-së dhe Revistën Shkencore të OMK-së.

Fushëveprimi

Neni 3

Departamenti i Financave, përkatësisht Zyrtari për Marketing pranë OMK-së, përgatit dhe pranon oferta dhe kërkesa. Kompetencë e departamentit janë edhe çmimoret, shkalla e uljes së çmimeve, procedurat, si dhe të gjitha llojet e ofertave, kontratat dhe promocioni.

Neni 4

Këshilli Drejtues i OMK-së në koordinim me Zyrtarin për Marketing përcaktojnë hapësirën dhe mundësinë e lejit të aktivitetit komercial.

KREU II - PËRKUFIZIMI I SHPREHJEVE

1. **OMK** -nënkupton Odën e Mjekëve të Kosovës.
2. **Marketing**- nënkupton aktivitetin komercial dhe shërbimet e marketingut.
3. **Ueb-faqe**-nënkupton ueb-faqen zyrtare dhe nën ueb-faqet e tjera të Odës së Mjekëve të Kosovës ku ofrohen shërbimet e marketingut (www.omk-rks.org)
4. **Revista Shkencore**-nënkupton Revistën në të cilën përveç publikimeve nga shkenca mjekësore, ofrohet mundësia e publikimit të reklamave sipas kërkesave.
5. **Shërbime komerciale**-nënkupton menaxhimin dhe kushtet e lejimit të aktivitetit komercial të marketingut.
6. **Hapësira reklamuese** -nënkupton hapësirën e lejuar për aktivitet komercial në ueb-faqen zyrtare dhe revistën shkencore.
7. **Çmimorja**- nënkupton listën me çmime për shërbimet e ofruara.
8. **Reklamuesi**- nënkupton individin apo biznesin i cili bën kërkesë për shfrytëzim të hapësirës reklamuese.

Kreu III –SHËRBIMET E OFRUARA

Neni 5

Përzgjedhja e ofertave për reklamim në ueb-faqen zyrtare të OMK-së dhe Revistën Shkencore të OMK-së përcaktohet konform dispozitave të kësaj Rregulloreje dhe dispozitave të Rregullores për Procedurat e Prokurimit të OMK-së.

Neni 6

OMK-ja obligohet t'i kryejë shërbimet e publikimit (transmetimit) të reklamave në bazë të porosisë së pranuar nga reklamuesit, përkatësisht në bazë të kontratës së nënshkruar, me kusht që reklamuesi t'i ketë shlyer më parë të gjitha obligimet ndaj OMK-së.

Neni 7

Nëse klienti nuk i ka përmbushur të gjitha detyrimet në bazë të kontratës së lidhur, OMK-ja ka të drejtë që të ndërpresë transmetimin e reklamës së porositur në ueb-faqen zyrtare të OMK-së, apo mospublikimin e reklamës në revistën shkencore.

Neni 8

1. OMK-ja në përputhje me kushtet e shitjes lidh kontrata me zbritje (ulje çmimesh) në rastet kur kontrata lidhet për dy shërbime promovimi si në ueb-faqen zyrtare dhe revistën shkencore, ku shumta e kontratës është mbi 500.00€(euro).
2. Reklamata ndahen në tri kategori:
 - 2.1. Ueb-faqe (web page)
 - 2.2. Revista Zyrtare e OMK-së, dhe
 - 2.3. Ueb-faqe dhe Revistë Zyrtare.

Neni 9

1. Kontratata për bashkëpunim klientët i lidhin me Odën e Mjekëve të Kosovës, gjegjësisht me Kryetarin e Odës, ndërsa asistencata administrative ofrohet nga zyrtari përgjegjës për marketing.
2. Porositë për reklama pranohen nga zyrtari për marketing pranë OMK-së dhe të njëjtat i dorëzohen zyrtarit të teknologjisë informative për t'i plasuar në ueb-faqen zyrtare të OMK-së, apo shtypshkronjës e cila do të jetë përgjegjëse për shtypjen e Revistës Shkencore të OMK-së.

Kreu IV – OFERTA PËR REKLAMË

Neni 10

1. Oferta për reklama përpilohet në përputhje me ofertat për reklama në ueb-faqen zyrtare dhe Revistën Shkencore të OMK-së.
2. Të gjitha ofertat, pakot, informatat shtesë dhe ndryshimet në lidhje me reklamim në ueb-faqen zyrtare dhe Revistën Shkencore përpilohen nga departamenti për financa dhe marketing, aprovohen nga Kryetari i OMK-së dhe pastaj publikohen.

Neni 11

Departamenti i Marketingut në OMK, ka këto kompetenca:

- ndryshon ofertat e publikuara për reklama dhe çmimet;
- krahas ofertave të rregullta, publikon edhe oferta të veçanta për reklama dhe sponsorizim;
- për format e mundshme të reja të reklamës dhe për ngjarje të veçanta, publikon oferta për reklama në çastin e fundit.

Kreu V – POROSIA E REKLAMËS

Neni 12

1. OMK-ja pranon reklamën drejtpërdrejtë nga klienti, me postë apo në mënyrë elektronike. Është e domosdoshme që të gjitha porositë para publikimit të reklamës, klienti t'i konfirmojë përmes postës elektronike tek zyrtari përgjegjës i marketingut.
2. Nëse zyrtari përgjegjës për marketing pranë OMK-së nuk e pranon një konfirmim të tillë të porosisë më së voni deri në ditën në të cilën do të publikohet porosia/reklama, për OMK-në ekzekutimi i porosisë nuk është i obligueshëm.
3. Zyrtari për marketing nëse vlerëson se reklama/porosia e klientit nuk i përmbahet kritereve dhe rregullave për reklamim në ueb-faqen zyrtare të OMK-së dhe Revistën Shkencore, reklama do të refuzohet.

Kreu VI – KËRKESAT THELBËSORE DHE TEKNIKE

Neni 13

1. OMK-ja pranon ofertat për reklama, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. OMK-ja nuk është e obliguar t'i publikojë porositë/reklamën që bien ndesh me dispozitat ligjore dhe publikimi i tyre do të refuzohet automatikisht.
3. Në rastet e refuzimit të publikimit të reklamës, klienti/porositësi mund të kërkojë sqarim me shkrim nga OMK-ja.

Neni 14

1. OMK-ja do të bëjë refuzimin e reklamave në këto raste:
 - 1.1. nëse përmbajtja e reklamës është në kundërshtim me konventat ndërkombëtare, Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet në fuqi;
 - 1.2. nëse reklama ka përmbajtje politike,
 - 1.3. nëse përmbajtja e reklamës bie ndesh me ligjin për shëndetësi, ligjin për OPSH-të, statutin e OMK-së, dhe aktet e tjera nënligjore të OMK-së,
 - 1.4. në rast se hapësira reklamuese nënkontraktohet nga kontraktuesi(klienti) pa dijeninë dhe lejen e OMK-së.

Neni 15

1. OMK-ja është e obliguar që:
 - 1.1. të publikojë reklamën gjatë gjithë kohës, siç është përcaktuar me kontratë,

1.2. të kthejë shumën e paguar për reklamë, nëse ndodhin gabime teknike si mospublikimi i reklamës apo publikimi i pjesëshëm,

1.3 në rast të mospublikimit të plotë apo të pjesëshëm, OMK duhet ta kompensojë klientin me shtyrje të afatit të kontratës.

Neni 16

1. OMK-ja nuk mban kurrfarë përgjegjësie lidhur me përmbajtjen e reklamave si dhe vërtetësinë e pohimeve të tyre.
2. Përgjegjësinë për përmbajtjen dhe vërtetësinë e pohimeve të reklamave e mban në tërësi klienti/porositësi.
3. OMK-ja para publikimit të reklamës, bën kontrollin përmbajtësor të saj. Zyrtari përgjegjës i teknologjisë informative pranë OMK-së, verifikon parametrat teknikë.

Neni 17

1. Regjistrimi i audio i materialit reklamues duhet të ketë së paku gjysmë sekonde hapësirë në fillim dhe në fund të tij.
2. Klienti/porositësi është i obliguar të dërgojë materialin reklamues përmes postës elektronike.

Neni 18

Të gjitha njoftimet, shpalljet apo reklamat, klienti/porositësi është i obliguar t'i pajisë me informacion në të cilin duhet të jenë të theksuara:

- emri i shpalljes, njoftimit apo reklamës, sasia e materialit, renditja,
- kohëzgjatja e saktë e shpalljes, njoftimit apo reklamës.

Kreu VII – ÇMIMI I REKLAMAVE DHE ÇMIMORJA

Neni 19

1. Çmimi i reklamës në hapësira të caktuara reklamuese të ueb-faqes zyrtare dhe revistës shkencore të OMK-së, është i caktuar në çmimoren vjetore për reklama, si dhe në ofertat e rregullta mujore dhe ofertat e veçanta për reklamim.
2. Vlera e reklamës është e përcaktuar në valutën Euro dhe çmimoret janë të shpallura publikisht.
3. Këshilli Drejtues i OMK-së ka kompetencë për të aprovuar çmimoren si dhe bëjë plotësim/ndryshimin e saj sipas nevojave, për arsye operationale shkaktuar nga luhatjet në çmime duke u bazuar në kërkesën e tregut dhe ofertave për çmime.

Kreu VIII – ZBRITJET DHE SHKALLA E ZBRITJEVE

Neni 20

1. Zbritjet llogariten në përputhje me shkallën e aplikueshme të zbritjeve të çmimoreve zyrtare të marketingut të OMK-së.
2. Vlera përfundimtare e reklamës është ajo vlerë të cilën e fitojmë pas të gjitha zbritjeve sipas çmimoreve. Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) në këtë rast nuk llogaritet.
3. Nëse klienti/porositësi e tejkalon shumën e kontraktuar atëherë me aneks kontratë precizohet rikalkulimi i shumës totale duke pasur për bazë çmimoren e publikuar të OMK-së.
4. Nëse klienti/porositësi nuk e përmbush shumën e kontraktuar atëherë rikalkulohet në bazë të shumës së shpenzuar sipas çmimoreve të publikuar të OMK-së.

Kreu IX – ZBRITJET TJERA TË VEÇANTA

Neni 21

1. Këshilli Drejtues i OMK-së rezervon të drejtën për ndryshimin e çmimeve në rastet kur paraqiten kërkesa të veçanta drejtuar departamentit për financa dhe marketing të OMK-së.
2. Këshilli Drejtues i OMK-së themelon Komisionin Vlerësues prej së paku tre (3) anëtarëve të cilët e bëjnë vlerësimin e kërkesës së Zyrtarit për Marketing, dhe i japin rekomandim me shkrim Këshillit Drejtues, i cili më pas nxjerrë vendim për aprovimin apo refuzimin e kërkesës për ndryshimin e çmimit.
3. Vendimi i Këshillit Drejtues është vendim përfundimtar ndaj të cilit nuk mund të ushtrohet e drejta në ankesë.

Kreu X – REKLAMIMI PA PAGESË

Neni 22

1. Reklamimet pa pagesë (falas) lejohen në rastet kur:
 - Kemi të bëjmë me ngritjen e vetëdijes së opinionit publik në fushat e: edukimit, arsimit, shëndetësisë dhe aktiviteteve humanitare.
2. Për rastet pa pagesë vendos Këshilli Drejtues i OMK-së, në bazë të kërkesave të paraqitura nga Zyrtari për Marketing, kërkesave të paraqitura drejtpërdrejtë dhe sipas hapësirës reklamuese në dispozicion.
3. Reklamimi pa pagesë mund të bëhet me Marrëveshje Mirëkuptimi dypalëshe edhe në rastet për ofrimin e shërbimeve të ndërsjella pa pagesë (OMK-klienti/porositësi).

Kreu XI– KONTRATA

Neni 23

1. Në përputhje me dispozitat e kushteve të shitjes sipas kësaj rregulloreje, OMK-ja do të lidh kontratë vjetore me reklamues të drejtpërdrejtë, agjencione, institucione, organizata, etj.
2. Kontratat mund të lidhen edhe me klientët që kanë më shumë se një biznes që mund të kenë numra të ndryshëm të regjistrimit, si dhe faturimi do të bëhet sipas kërkesës së klientit, d.m.th. buxheti i bizneseve mund të llogaritet si buxhet i tërësishëm i klientit.
3. Pjesë përbërëse e kontratës është edhe çmimorja e marketingut e OMK-së. Kontrata është fshehtësi afariste dhe personave të tretë nuk u lejohet qasja në të, me përjashtim të atyre që janë të autorizuar me ligj.
4. Afati kohor i kontratës mund të vazhdohet vetëm në rastet e veçanta kur kemi kërkesa të specifikuar nga klienti, të cilat do të shqyrtohen dhe do të aprovohen apo refuzohen me vendim nga Këshilli.
5. Të gjitha bizneset të cilat janë të regjistruara si prodhues vendor në ARBK, pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, OMK-ja do t'i trajtojë si të tilla.
6. Reklamimi i produkteve farmaceutike dhe pajisjeve medicinale lejohet vetëm nëse bizneset posedojnë autorizim për marketing nga Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale (AKPPM) në pajtim me Nenin 16 të Ligjit Nr. 04/L-190 për Produkte dhe Pajisje Medicinale si dhe në pajtim me Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2015 për Autorizim për Marketing për Produkte Medicinale.
7. Hapësira reklamuese e kontraktuar nuk lejohet të nënkontraktohet.

Neni 24

1. Zyrtari për marketing pranë OMK-së, së bashku me zyrën ligjore, është përgjegjës për vlerësimin e kontratave dhe dhënien e rekomandimit rreth tyre tek Kryetari i OMK-së, i cili pas aprovimit bën nënshkrimin e kontratave për hapësirë reklamuese me klientë.
2. Kontrata përpilohet bazuar në dispozitat e kësaj Rregulloreje.

Kreu XII– PAGESAT PËR SHËRBIME

Neni 25

OMK-ja ia dorëzon klientit/porositësit faturën për reklamën e porositur dhe të konfirmuar, më së largu 5 (pesë) ditë pas përfundimit të muajit, për muajin paraprak.

Neni 26

1. OMK-ja rezervon të drejtën që klientëve/porositësve të cilët nuk i kryejnë obligimet kontraktuale, të mos iu ofrojë shërbim deri në shlyerjen e të gjitha obligimeve.

2. OMK-ja rezervon të drejtën që klientëve/porositësve të cilët nuk i përmbahen marrëdhënies kontraktuale për shërbimin e marketingut'ua diskualifikojë kërkesat për reklamim në të ardhmen.

Neni 27

1. Afatet e pagesës dhe kushtet e tjera të pagesës për klientët me kontrata të lidhura janë të përcaktuara me kontratë.
2. Afati i pagesës për reklamues të cilët nuk kanë kontratë të lidhur për reklamim bëhet para fillimit të publikimit të reklamës.

Kreu XIII-SIGURIMI I PAGESËS

Neni28

Mjetet për sigurimin e pagesës për partnerët kontraktualë janë të përcaktuara në kontratë.

Kreu XIV-REKLAMACIONI

Neni 29

1. OMK-ja pranon ankesën për reklamën e publikuar (me gabime teknike) më së largu 10 (dhjetë) ditë pas publikimit të reklamës.
2. OMK-ja nuk është e obliguar t'i shqyrtojë ankesat që arrijnë pas afatit të paraparë ligjor.
3. Ankesa i drejtohet Këshillit Drejtues të OMK-së, si dhe vendimi i këtij organi të OMK-së nuk mund të atakohet me procedurën e ankimit.

Neni 30

1. Klienti/porositësi mund të paraqesë vërejtje në faturën e pranuar jo më larg se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas dorëzimit të saj dhe atë në formë të shkruar duke theksuar arsyet e kthimit.
2. OMK-ja nuk është e obliguar të shqyrtojë reklamimin e faturës pas skadimit të afatit të paraparë ligjor.
3. Në rast se pranohet reklamacioni i faturës, origjinali i saj duhet të kthehet në OMK.

Kreu XV-SHËRBIME TË TJERA

Neni 31

1. Kryetari i OMK-së, me pëlqimin e Këshillit Drejtues të OMK-së, ka të drejtë t'ia shesë një pjesë apo tërë hapësirën reklamuese një agjencie të marketingut, nëse OMK-ja ka dobi më të mëdha financiare se mënyra aktuale nga shitjae reklamës.
2. Përzgjedhja e agjencisë së marketingut në këtë rast bëhet në bazë të ofertave konkrete të agjencive apo edhe me shpallje publike për shprehje interesi.
3. Reklamat që publikohen në kundërshtim me këtë rregullore dhe pa pasur kontratë me OMK-në, Zyrtari për Marketing obligohet t'i evidentojë dhe të informojë për këto shkelje Kryetarin e OMK-së dhe Këshillin Drejtues të OMK-së.

Kreu XVI- DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 32

1. Inicimi i ndryshimit të kësaj rregulloreje mund të bëhet nga Departamenti për Financa dhe Marketing dhe Këshilli Drejtues i OMK-së, në rastet kur paraqiten nevoja më të favorshme se që janë paraparë në këtë rregullore dhe çmimore.
2. Çmimorja për shërbimet e marketingut do të jetë pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.
3. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje bëhen sipas të njëjtës procedurë të miratimit.
4. Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të saj nga Kuvendi i OMK-së.

Prishtinë, 26 dhjetor 2023

Kryetari i OMK-së

Dr.Pleurat Sejdiu, Mr. Sci



SHTOJCA I

ÇMIMORE MARKETINGU PËR UEB-FAQE TË OMK-SË

www.omk-rks.org është adresa e ueb-faqes zyrtare e Odës së Mjekëve të Kosovës

Hapësirat reklamuese në omk-rks.org janë të ndara në tre pozicione:

Pozicioni 1: Baner 970x250px

Pozicioni 2: Baner footer 970x250 px

Pozicioni 3: Baner: 300x250px

Caktimi i çmimeve është bërë në bazë të trafikut vjetor në ueb-faqe

Pozicioni 1: Baner


Në Pozicionin 1 është mundësia e shfaqjes së hapësirës reklamuese në pjesën e sipërme të ballinës së faqes, me dimensione 970x270 px.

Çmimi për këtë pozicion është:

Kohëzgjatja	Çmimi
1 muaj	50 €
3 muaj	120 €
6 muaj	200 €
1 vjet	350 €

Kongresi dhe Panairi i Parë i Mjekësisë
18-19 Tetor 2019 Hotel Emerald Prishtinë KONGRESI

BILLBORD 970x250



Vendim për masat e marra për mbrojtje nga përhapja e virusit COVID-19


Lexo më shumë >

Data e publikimit: 26 Shtator 2020

SHERBIM I SHPEJTË

- » Formularët
- » Anëtarisimet
- » EVP
- » Licencimi
- » Fondi i Solidaritetit
- » Ofertat e vulltshme për anëtarët
- » Kalendari

Të fundit



Pyetësor studimi "Vlerësimi i mirëqenies psikologjike të punonjësve shëndetësor gjatë pandemisë COVID-19 në Kosovë"



FSSHK kërkon në kuadër të rishikimit të buxhetit të aprovohet edhe shtesa në paga



Vendim që të dhurohen mjetet financiare të dedikuara për amiljet e mjekëve që kanë vdekur si pasojë e infektimit me virusin COVID-19

Ngjarjet e ardhshme

1 Tetor 31 Tetor	MUAJI I NDERQECJESIMIT PER KANCERIN E GJIRIT
15 Tetor	Dita ndërkombëtare e larjes së duarve
29 Tetor	Dita Botërore e Goditjeve Cerebrale
14 Nëntor	Dita Botërore e Diabetit

Pozicioni 2. Baner footer

Në Pozicionin 2 është mundësia e shfaqjes së hapësirës reklamuese në pjesën e poshtme të ballinës së faqes, me dimensione 970x270 px.

Çmimi për këtë pozicion është:

Kohëzgjatja	Çmimi
1 muaj	40 €
3 muaj	96 €
6 muaj	160 €
1 vjet	280 €

ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS | KQKQ | BURET OMK-SE | KONTAKT REPUBLIKË E KOSOVËS

RRETH OMK-SE LAJMET PËR PUBLIKUM PËR ANTARE KALENDAR I EVJ-SE VEËEZA

Pyetësor studimi "Vlerësimi i mirëqenies psikologjike të punonjësve shëndetësor gjatë pandemisë COVID-19 në Kosovë"
 Departamenti i Psikologjisë i Universitetit të Prishtinës në bashkëpunim me Oden e Mjekëve dhe infermierëve të Kosovës kërkoi në përqendrimin tuaj mjekë...

Njoftim për dhënie të Kontratës për furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative të OMK-së
 Komisioni për Vlerësim/Përzgjedhje të tenderit për "Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative të OMK-së" ka njeri njoftimin për dhënie të...

Vendim për masat e marra për mbrojtje nga përhapja e virusit COVID-19
 Qeveria e Republikës së Kosovës sipas kërkesës së Ministrisë së Shëndetësisë në mbledhjen e mbajtur më 25 shtator ka rojet...

29 Tetor Dita Botërore e Goditjeve Cerebrale
 14 Nëntor Dita Botërore e Diabetit

MËSHUME


BILLBORD 970x250

Paraqitja e sulmit ndaj mjekëve

MËSHUME

Donatorët

"Aktivitetet e Odës së Mjekëve të Kosovës mbështeten nga fondet e Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Luksemburgut përmes projektit KSV/017 "Programi Mbështetës për Shëndetësi në Kosovë - Faza II"



BALLINA | KONTAKTI | RRETH OMK-SE

PUNA ME PALE:
E HËNË - E PREMTE PREJ ORES 8.30-18.30

NËN LLOGARIA PËR SOLIDARITET:
NLB BANK 1708017700002308
IBAN: XK05 1708017700002308

XHIRO LLOGARIA E OMK-SE:
BANKA NLB BANK
EMRI I LLOGARISË: ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
NUMRI I LLOGARISË: 1708001600081988

RR. ÇUKUK INSTITUTI A, KATI I III-TË, 10 000 - PRISHTINE
INFO@OMK-RKS.ORG
+386 49 872 300 | +386 49 872 070

NR. FIX: 038544872 | CENTRIX: 03820024188

Pozicioni 3. Baner


Në Pozicionin 3 është mundësia e shfaqjes së hapësirës reklamuese në pjesën e sipërme të ballinës së faqes, me dimensione: 300x250 px.

Çmimi për këtë pozicion është:

Kohëzgjatja	Çmimi
1 muaj	35 €
3 muaj	84 €
6 muaj	140 €
1 vjet	245 €

Kongresi dhe Panairi i Parë i Mjekësisë
18-19 Tetor 2019 Hotel Emerald Prishtinë

KONGRESI



Vendim për masat e marra për mbrojtje nga përhapja e virusit COVID-19


[Lexo më shumë >](#)

Data e publikimit: 26 Shtator 2020

SHËRBIIM I SHPEJTË

- » Formularët
- » Anëtarizimet
- » EVP
- » Licencimi
- » Fondi i Solidaritetit
- » Ofertat e volitshme për anëtarët
- » Kalendar

Të fundit



Pyetësor studimi "Vlerësimi i mirëqenies psikologjike të punonjësve shëndetësor gjatë pandemisë COVID-19 në Kosovë"

Departamenti i Psikologjisë i Universitetit të Prishtinës në bashkëpunim me Odën e Mjekëve dhe Infermierëve të Kosovës kërkoi në pajtimin e kujdesit...



Njoftim për dhënie të Kontratës për furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative të OMK-së

Komisioni për Vlerësim/Përzgjedhje të tenderit për "Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative të OMK-së" ka njeri njoftimin për dhënie të...



Vendim për masat e marra për mbrojtje nga përhapja e virusit COVID-19

Qeveria e Republikës së Kosovës sipas kërkesës së Ministrisë së Shëndetësisë në mbledhjen e mbajtur me 25 shtator ka njeri...

Baneri
300x220



FSSHK kërkon në kuadër të rishikimit të buxhetit të aprovohet edhe shtesa në paga

29 KORRIK 2020



Njoftim lidhur me procesin e rekrutimit për shkolim specialistik

04 QUSHT 2020



Vendim që të dhurohen mjetet financiare të dedikuara për familjet e mjekëve që kanë vdekur si pasojë e infektimit me virusin COVID-19

30 KORRIK 2020

Ngjarjet e ardhshme

- 1 Tetor 31 Tetor: **MUADI I NDEROJEGJESIMIT PER KANCERIN E CEFIT**
- 15 Tetor: **Dita nderkombetare e larjes se duarve**
- 20 Tetor: **Dita Ebtarone e Gorrjeve Cerebrale**
- 14 Nentor: **Dita Ebtarone e Diabetit**

ME SHUME

STATISTIKAT VJETORE TË VIZITORËVE NË UEB-FAQEN www.omk-rks.org


Audience Overview sep 19 - 20

Sep 4, 2019 - Sep 4, 2020


All Users
100.00% Users

Overview

Users



■ New Visitor ■ Returning Visitor



Country	Users	% Users
1. Kosovo	24,183	82.22%
2. Albania	1,160	3.94%
3. Germany	916	3.11%
4. United States	647	2.20%
5. Switzerland	555	1.89%
6. North Macedonia	239	0.81%
7. Austria	148	0.50%
8. Serbia	130	0.44%
9. United Kingdom	129	0.44%
10. Sweden	126	0.43%

SHTOJCA II

TARIFAT PËR HAPËSIRAT PROMOVUESE NË REVISTËN MJEKU

Për faqe të brendshme bardhë e zi:

Madhësia	Çmimi
Faqe e plotë	350.00 €
1/2 faqe	180.00 €
1/4 faqe	130.00 €
1/5 faqe	90.00 €
1/8 faqe	70.00 €
1/10 faqe	50.00 €

Për faqe të brendshme me ngjyra:

Madhësia	Çmimi
Faqe e plotë	500.00 €
1/2 faqe	350.00 €
1/4 faqe	200.00 €
1/5 faqe	100.00 €
1/8 faqe	80.00 €
1/10 faqe	60.00 €

Çmimi për faqen e fundit do të jetë në vlerë prej 1000.00 € (njëmijë euro).

Përcaktimi i taksës për publikim të artikullit të sponsorizuar në Revisten "MJEKU" përrnbanë këto çmime:

- Artikulli i sponsorizuar deri në 750 (shtatëqind e pesëdhjetë) fjalë me përrnbajtje të një fotografie të formatit 1/5 e faqës së revistës, çnimi do të jetë në vlerë prej 700.00 € (shtatëqind euro).
- Artikulli i sponsorizuar deri në 800 (tetëqind) fjalë, pa përrnbajtje të fotografisë, çmimi do të jetë në vlerë prej 700.00 € (shtatëqind euro).

Fjale	Përrmbajtja e fotografive, tabelave apo grafikoneve	Çmimi
750 fjalë	1/5 e faqes	700.00 €
800 fjalë	pa përrnbajtje	700.00 €

SHTOJCA III

TARIFAT PËR HAPËSIRAT PROMOVUESE TË PRODUKTEVE MJEKËSORE NË KONGRESET E ORGANIZUARA NGA OMK

Kohëzgjatja e prezantimit të produktit do të jetë minimum 5 (pesë) minuta dhe jo më e gjatë se 7 (shtatë) minuta. Çmimi për prezantimin e produktit për një minutë do të jetë në vlerë prej 100 € (njëqind euro).

Kohëzgjatja	Çmimi
5 minuta	100.00 €/për minut
6 minuta	100.00 €/për minut
7 minuta	100.00 €/për minut

Prishtinë, 26 dhjetor 2023

Kryetari i OMK-së

Dr. Pleurat Sejdiu, Mr. Sci

